REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Br. 981/20
Datë/Datum. 14.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.981/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, ne përbërje te: Blerim Dina - Kryetar, panelist individual duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "OntexiMont" shpk- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik N.N"GLOBAL-ING"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Grryerja e parketit ne palestrën sportive 1 Tetori", me nr. prok. QA 20-025-521, iniciuar nga autoriteti kontraktues/AK/ Qendra e Studenteve e Universitetit te Prishtinës më datën: 14.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Ontexi Mont"shpk- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Grryerja e parketit ne palestrën sportive 1 Tetori", me nr. prok. QA 20-025-521, iniciuar nga autoriteti kontraktues/AK/ Qendra e Studenteve e Universitetit te Prishtinës.

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin prokurimit me titull: "Grryerja e parketit ne palestrën sportive 1 Tetori", me nr. prok. QA 20-025-521, iniciuar nga autoriteti kontraktues/AK/ Qendra e Studenteve e Universitetit te Prishtinës, dhe lënda kthehet ne **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik "OntexiMont"shpk- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "OntexiMont" shpk- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 20.11.2020 me nr. 981/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Grryerja e parketit ne palestrën sportive 1 Tetori", me nr. prok. QA 20-025-521, iniciuar nga autoriteti kontraktues/AK/ "Qendra e Studenteve e Universitetit te Prishtinës", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 28, 60, 61, 68 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.11.2020, ka autorizuar eksperten profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt: 04.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje lidhur me pretendimet e Operatorit Ekonomik Ankues.
Ekspertja Shqyrtuese Profesionale e Prokurimit Publik, fillimisht sqaron për Operatorin Ekonomik Ankues se Autoriteti Kontraktues, pas rivlerësimit të tenderit, ka vazhduar procedurat e prokurimit në bazë të Ligjit për Prokurim Publik lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Duke mos anashkaluar asnjë pikë në bazë të LPP-së dhe duke vepruar në harmoni të plotë të këtij ligji.
Ekspertja shqyrtuese konstaton se në bazë të dokumenteve të poseduara, Operatorit Ekonomik ankues iu është lejuar qasja në dokumentacione për procedurën e prokurimit publik të lartë përmendur. Lidhur me pretendimin ankimor ku thuhet se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat për specifikime teknike, ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik dhe konkretisht ligjin nr. 04/L - 042 ku njëherit lejohet plotësimi I dokumentacionit shtesë, Autoriteti kontraktues pas kërkesës së OSHP-së për rivlerësimin e procedurës për këtë aktivitet të prokurimit, vjen në përfundim se ka vepruar në harmoni me rregullat e LPP-së dhe se pretendimi i Operatorit Ekonomik

Ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor ku thuhet se OE fitues nuk ka ofruar punëtorë të mjaftueshëm, sqarojmë se pas rivlerësimit Autoriteti Kontraktues ka vepruar në bazë të LPP-së, pasi që ka përzgjedhur OE për kontratë i cili i plotëson kërkesat sipas pikave në njoftimin për kontratë. Andaj bazuar në dokumentacionet dëshmi edhe ky pretendim ankimor është pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor ku thuhet se AK ka përzgjedhur OE fitues njëherit i cili ka ofruar çmim më të ulët për këtë aktivitet të prokurimit, duke u bazuar në dokumentacionin që OE fitues ka ofruar dhe në dokumentacionet e AK-së ku asnjë Operator Ekonomik nuk ka rezultuar të ketë ofruar çmim jo normalisht të ulët, konsiderojmë se edhe në këtë aspekt Autortiteti Kontraktues ka vepruar në harmoni me LPP-në.
Ekspertja shqyrtuese konstaton se duke u bazuar në nenin 1 të Ligjit për Prokurim Publik ku thuhet se qëllimi i këtij neni është të sigurojë mënyrën më efikase më transparente dhe me të drejtë që të shfrytëzohen fondet publike, Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka plotësuar kushtet edhe sa i përket çmimit të ofruar për këtë aktivitet të prokurimit publik. Mirëpo kërkojë nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit, që gjatë seancës dëgjimore të kërkoj një lloj shpjegimi nga OE fitues duke na prezantuar një lloj plan programi se si do të arrihen plotësimi i kërkesave në bazë të çmimit të ofertuar.

Duke pasur parasysh se Oferta e Operatorit Ekonomik ankues "OntexiMont" SH.p.k, për plotësimin e kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, ka rezultuar të ketë çmim të lartë, më konkretisht nuk qe tenderi me çmimin më të ulët, përkitazi me nenin 1 të LPP-së. Ekspertja Shqyrtuese Profesionale e Prokurimit Publik Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 ka shikuar, analizuar dhe shqyrtuar pikat ankimore dhe vjen ne përfundim duke konsideruar si te pa bazuar ankesën e Operatorit Ekonomik.
Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese Profesionale e Prokurimit Publik I propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të refuzohet** si e pa bazuar, dhe rekomandon që Autoriteti Kontraktues të **vazhdojë me hapat e mëtutjeshëm**.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 07.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 08.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Nuk Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

E konfirmojmë pranimin e mendimit të ekspertit nr 981-20. Këtë mendim të ekspertit e kundërshtojmë plotësisht dhe i propozojmë Panelit Shqyrtues të mos i falë besimin për shkak se e njëjta është kontradiktore dhe e pa qëndrueshme. Konsiderojmë se specifikimi teknik i detyrueshëm nuk mund të plotësohet në fazat në të cilat OE i shpallur fitues e ka plotësuar. Sipas vlerësimit tonë çdo plotësim/ndryshim i specifikimit të detyrueshëm teknike do të kishte kuptim vetëm nëse bëhet para hapjes së tenderëve.
Ekspertiza është tejet e mangët dhe nuk paraqet drejt gjendjen faktike, edhe pse kemi situate të njëjtë me procedurën paraprake, ekspertiza e tanishme ka kundërthënie të theksuara me ekspertizën e parë dhe meqenëse ekzistojnë lëshimet e njëjta këto tani nuk janë elaboruar mjaftueshëm dhe si rezultat i kësaj kemi këtë ekspertizë.

Andaj i propozojmë Panelit Shqyrtues që të analizoj njëkohësisht të dy ekspertizat dhe të i falë besimin ekspertizës e cila është më bindëse dhe të sjell Vendim me të cilin e aprovon Ankesën tonë dhe e detyron AK të veproj konform detyrimeve ligjore.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 14.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "OntexiMont" shpk- Prishtinë, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat për specifikime teknike, Paneli Shqyrtues sqaron se me te drejte është ankuar OE ankues dhe gjate rivlerësimit te vlerësohen vetëm ofertat siç janë dorëzuar ne ditën e hapjes e jo te behën ndryshime substanciale, dhe nëse kërkohen sqarime shtese ato duhet te jene ne përputhje me nenin 72 te LPP-se.

Lidhur me pretendimin ankimor, ku thuhet se OE fitues nuk ka ofruar punëtorë të mjaftueshëm, Paneli Shqyrtues sqaron se gjate rivlerësimit AK duhet te ketë kujdes edhe per këtë pike se nëse kërkohen sqarime shtese ato duhet te jene ne përputhje me nenit 72 te LPP-se.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "QSUP";

1x1 OE "ONTEXI MONT" SH.P.K;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.